

UDHËZUES MBI PORTALIN E SINJALIZIMIT TË WEBFAQEVE ME PËRMBAJTJE TË PALIGJSHME

Raporto Përmbajtje të Paligjshme





U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Botimi është pjesë e projektit ““Ekosistem kibernetik më i sigurt nga ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri”, i mbështetur nga ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorit /eve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Botues: Akademia e Studimeve Politike

Adresa: Rruga Emin Duraku, pallati Credins, kati 7, ap 21, Tiranë

Tel: +355 04 5629047, email: info@asp.al, web: www.asp.al

© ASP 2021 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për Akademia e Studimeve Politike, Tiranë/Shqipëri



HYRJE

Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit ofrojnë mundësi të shumta për shkëmbimin e njohurive dhe dialogun ndërkulturor. Ato janë bërë pjesë e pandashme e jetës së përditshme, veçanërisht për fëmijët dhe të rinjtë. Njëkohësisht me përfitimet që sjell për shoqërinë, ky zhvillim teknologjik ofron gjithashtu mundësi për keqpërdorimin dhe përhapjen e shpejtë të materialeve të paligjshme. Ekspozimi ndaj imazheve të dëmshme dhe pornografia apo gjuha e urrejtes që nxit dhunën, racizmin dhe radikalizimin e të rinjve, janë një kërcënim serioz për sigurinë si dhe për dinjitetin e viktimave.

Këto materiale që qarkullojnë online janë të paligjshme dhe duhet të trajtohen me të njëjtën forcë të ligjit. Institucionet ligjzbatuese, të cilat janë përgjegjëse për sigurinë kibernetike u janë përgjigjur këtyre shqetësimeve përmes mekanizmave dhe masave të ndryshme. Një prej tyre, është dhe "Portali unik për mbylljen e aksesit të faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme". Ky mekanizëm i ri krijon mundësinë e sinjalizimit të thjeshtë dhe anonim nga përdoruesit e internetit dhe ndërveprimin e shpejtë të institucioneve publike dhe ofruesve të shërbimeve të internetit (ISP-ve) me qëllim mbylljen e aksesit në faqet e raportuara me përmbajtje të paligjshme sipas legjislacionit në fuqi.

Megjithatë, zbulimi i përmbajtjes së paligjshme online dhe fshirja e shpejtë e saj paraqet një sfidë edhe për vendet më të zhvilluara dhe kërkon një bashkëveprim të ngushtë të aktorëve publikë, privatë dhe përdoruesve të internetit. Ky material synon të promovojë për publikun e gjerë portalin unik të sinjalizimit si dhe ndërgjegjësojë aktorët e ndryshëm publikë dhe privatë mbi rëndësinë e bashkëpunimit për evidentimin dhe heqjen e shpejtë të materialeve me përmbajtje të paligjshme.



PËRKUFIZIME

“Faqe interneti me përmbajtje të paligjshme” – përfshijnë, por pa u kufizuar, faqe interneti që paraqesin kërcënim për hapësirën e internetit në Shqipëri si dhe faqe interneti me përmbajtje abuzive, ofenduese, raciste, të pamoralshme, fyese dhe denigruese për shkaqe rrace, ngjyre, seksi, kërcënuese, pornografike, online gambling (bixhoz online), pornografi me fëmijët, thirrje ksenofobe, etj. të përcaktuara si vepra të dënueshme nga legjislati shqiptar.

“Portal online” - Sistemi unik online, i cili është ngritur dhe administrohet nga AKCESK në zbatim të VKM. 141/2017.

“Portal Module” - Moduli nëpërmjet të cilit realizohen raportime për përmbajtje të paligjshme nga publiku, i aksesueshëm në www.cesk.gov.al

“Listë e zezë” (blacklist) - Listë me faqe të internetit me përmbajtje të paligjshme;

“Listë e bardhë” (Whitelist) - Listë me faqe interneti të cilat nuk rezultojnë më me përmbajtje të paligjshme, prandaj nuk janë më pjesë e listës së zezë (blacklist) dhe duhen hequr nga kjo e fundit.

“Proces i qendëruar” - proces i dokumentimit të të gjitha procedurave dhe listave në mënyrë të shpejtë dhe të saktë.

“Mbyllje aksesi të një faqe interneti me përmbajtje të paligjshme” - masë teknike, e cila ka si qëllim të kufizojë aksesin në Republikën e Shqipërisë në faqet e internetit me përmbajtje të paligjshme.

Ekstremizmi i dhunshëm - Kur një person ose grupim beson që frika, terrori dhe dhuna janë mjete të justifikueshme për të arritur ndryshime ideologjike, politike ose shoqërore dhe më pas vepron mbi këto besime.

Radikalizimi - Procesi me të cilin një person adopton pikëpamje apo praktika ekstreme deri në pikën e legjitimitit të përdorimit të dhunës.

Terrorizmi - Veprime apo një strategji e veçantë që përdoret për të arritur një objektiv ideologjik, politik ose shoqëror duke krijuar dhe shfrytëzuar qëllimisht frikën.



PËRCAKTIMI I PËRMBAJTJES SË PALIGJSHME

Çdo veprim i dënueshëm në "jetën reale" duhet të jetë i paligjshëm edhe kur ndodh në hapësirën online. Një përkthim i përgjithshëm i përmbytjes së paligjshme mund të jetë çdo aktivitet, informacion ose material i ngjashëm që bie në kundërshtim me ligjin dhe mund të dëmtojë dhe / ose të shkaktojë paragjykim për një individ ose entitet.

Përmbytja e paligjshme përfshin imazhe dhe mesazhe në rrjete sociale, faqe interneti, dhoma diskutimi (chat dhe blogje), që paraqesin fyerje, dhunë, urrejtje, racizëm, pornografi apo forma të tjera denigruese ndaj personave apo grupimeve të caktuara. Këto dhe të tjera forma të sjelljes së dënueshme janë përfshirë në Konventën e Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik¹, traktati i parë ndërkombëtar mbi krimet e kryera përmes internetit dhe rrjeteve të tjera kompjuterike, (ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8888, datë 25.4.2002), si dhe Protokollin Shtesë i Konventës për Krimin Kibernetik, në lidhje me kriminalizimin e akteve të një natyre raciste dhe ksenofobike të kryer përmes sistemeve kompjuterike.

Konventa për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual² (Lanzarote Convention) gjithashtu përfshin mbledhjen dhe ruajtjen e paautorizuar të të dhënave dhe kërkimin e informacionit. Kjo Konventë është traktati i parë ndërkombëtar që vendos ndëshkime penale për të gjitha format e seksualitetit dhe dhunës ndaj fëmijëve.

Sipas kuadrit ligjor evropian përkufizohen katër kategori kryesore të përmbytjes së paligjshme online:

<p>Materiale të abuzimit seksual të fëmijëve;</p> 	<p>Gjuha e urrejtjes, racizmi dhe ksenofobia;</p> 	<p>Përmbytja që nxit terrorizmin;</p> 	<p>Përmbytja që shkel të Drejtat e Pronës Intelektuale</p> 
---	---	---	--

1 CETS no.185 - Konventa Evropiane për Krimin Kibernetik, Budapest 23.11.2001 - <https://rm.coe.int/1680081561>

2 CETS no.201 - Mbrojtja e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, 25.10.2007- <https://rm.coe.int/168046e1e3>

Hapat e shpejta të zhvillimit të internetit dhe teknologjisë kanë bërë të domosdoshme rregullimin ligjor të kësaj fushe.

- ▶ Direktiva Kundër Terrorizmit³ përcakton provokimin publik për të kryer një vepër terroriste në aspekt të gjerë, pasi ajo mbulon avokimin indirekt dhe <glorifikimin> e akteve terroriste. Përcaktimi në këtë direktivë, kërkon vetëm që sjellja të shkaktojë rrezik se mund të kryhen veprat penale, por nuk kërkon që sjellja të krijojë një rrezik aktual ose një rrezik të pashmangshëm dëmi, i cili do të ishte më i vështirë për t'u adresuar.

Në vitin 2018, Komisioni Evropian propozoi një Rregullore për parandalimin e shpërndarjes së përmbajtjes terroriste në internet (TERREG), duke trajtuar vecanërisht keqpërdorimin e shërbimeve të hostuesve për qëllime terroriste. Komisioni përcakton përmbajtjen terroriste, si materiale që nxisin ose përkrahin kryerjen e veprave terroriste, inkurajojnë kontributin në veprat terroriste, promovojnë aktivitetet e një grupi terrorist ose sigurojnë metoda dhe teknika për kryerjen e veprave terroriste.⁴

Korniza ligjore e Bashkimit Evropian dhe një sërë dokumentash orientues përcaktojnë rolin e rëndësishëm që duhet të luajnë institucionet publike dhe ofruesit e platformave online për të adresuar keqpërdorimin e shërbimeve të tyre për të shpërndarë materiale të paligjshme si dhe rëndësinë që ka heqja/bllokimi i shpejtë i këtyre materialeve nga hapësira online. Më 29 prill 2021 u miratua nga Parlamenti Evropian rregullorja 2021/784 për "adresimin e përmbajtjes terroriste online"⁵, e cila përcakton detyrimin e ofruesve të shërbimit të platformave online për të hequr përmbajtjen terroriste të referuar nga autoritetet e shteteve anëtare brenda 1 orë nga marrja e njoftimit. Ky detyrim do të fillojë efektin e tij nga data 7 korrik 2022.

- ▶ Direktiva e Abuzimit Seksual dhe Shfrytëzimit të Fëmijëve (CSAED) përcakton rregullat minimale në lidhje me përkufizimin e veprave penale dhe sanksioneve në fushën e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve. Direktiva parashikon një përkufizim të gjerë të Materialit të Abuzimit Seksual të Fëmijëve (CSAM) që përfshin pornografinë e

3 Directiva 2017/541 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian, datë 15 Mars 2017 për goditjen e terrorizmit, OJ [2017] L 88/6

4 Propozimi i Komisionit Evropian i 12 shtator 2018 për një Rregullore të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për parandalimin dhe përhapjen e përmbajtjes terroriste online COM (2018) 640

5 Rregullorja e Parlamentit Evropian 2021/784 për "adresimin e përmbajtjes terroriste online - https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv:OJ.L_.2021.172.01.0079.01.ENG

- ▶ fëmijëve që përshkruan vizualisht një fëmijë të angazhuar në sjellje të qartë ose të simuluar seksuale ose pornografi virtuale e fëmijëve, d.m.th. materiale pornografike të krijuara në kompjuter që përfshijnë fëmijë.

Në lidhje me të Drejtat e Pronësisë Inteljektuale, është arritur harmonizimi në nivelin e BE-së përmes Direktivave të ndryshme të BE-së siç është Direktiva InfoSoc, e cila harmonizon të drejtat e riprodhimit, shpërndarjes dhe komunikimit për publikun dhe mbrojtjen ligjore të pajisjeve dhe të drejtave të copyright në sistemet e menaxhimit të të drejtave.⁶

Në të njëjtën linjë me këto zhvillime në Bashkimin Evropian është duke u orientuar edhe **kuadri ligjor i Republikës së Shqipërisë**.

- ▶ Legjislacioni vendas përkufizon përmbajtje të paligjshme online: çdo pamje, imazh dhe material tjetër, që qarkullon në internet, dhe që, sipas legjislacionit në fuqi, është i ndaluar pasi përbën vepër penale⁷
- ▶ Në zbatim të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, përmbajtje të dëmshme janë: çdo pamje, imazh dhe çdo material tjetër që qarkullon në internet dhe që cenon dinjitetin dhe të drejtat e fëmijës.⁸
- ▶ Në zbatim të ligjit nr.115/2015 "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit ka të drejtë të kërkojë bllokimin e menjëhershëm të faqeve të internetit, të cilat ofrojnë zhvillimin e lojërave on-line, të palicencuara apo në shkelje të dispozitave të ligjit.
- ▶ Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", ofruesit e shërbimeve mediatike, duhet të sigurojnë marrjen e masave për ndalimin e publikimeve me përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për fëmijët dhe publikun e gjerë.

6 Directiva 2001/29 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian datë 22 Maj 2001 për harmonizimin e të drejtave të copyright dhe të drejtave respektive në shoqërinë e informacionit, O.J. [2001] L167/10

7 Vendim Nr. 465, datë 3.7.2019 Për masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet

8 Ligji nr.18/2017 Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës

Kodi Penal përmban një numër dispozitash që penalizojnë veprat penale të kryera përmes internetit, të renditura si më poshtë vijon:



- Neni 74 / a - Shpërndarja kompjuterike e materialeve pro gjenocidit ose krimeve kundër njerëzimit;
- Neni 84 / a - Kanosja me motive racizimi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik;
- Neni 117 – Pornografia;
- Neni 119 / a - Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik;
- Neni 119 / b - Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik;
- Neni 143 / b - Mashtrimi kompjuterik;
- Neni 186 / a - Falsifikimi kompjuterik;
- Neni 192 / b - Hyrja e paautorizuar kompjuterike;
- Neni 232 - Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ;
- Neni 232/a - Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste
- Neni 293 / a - Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike;
- Neni 293 / b - Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike;
- Neni 293 / c - Ndërhyrja në sistemet kompjuterike;
- Neni 293 / ç - Keqpërdorimi i pajisjeve

Në kuadrin ligjor kombëtar, nuk ka një ligj specifik që rregullon në mënyrë të qartë bllokimin dhe / ose filtrimin e internetit nga përmbajtjet e paligjshme. Megjithatë, rregulloret, në nivelin e akteve nënligjore, përmbajnë dispozita për bllokimin dhe / ose filtrimin e përmbajtjes së paligjshme të internetit, në veçanti për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve. Vetërregullimi nga ana e ofruesve të shërbimit të internetit dhe platformave online, luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në këtë aspekt.

PORTALI UNIK I SINJALIZIMIT

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), është institucion publik, i cili ushtron veprimtarinë e tij nën autoritetin e Kryeministrit, në përputhje me Ligjin Nr. 9880/2018

“Për Nënshkrimin Elektronik”, Ligjin Nr. 107/2015, datë 1.1. 2015 “Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara” si dhe Ligjin Nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”.



Si një nga detyrat e tij funksionale⁹, AKCESK ka ndërtuar dhe mirëmban **Portalin unik online për publikimin e faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme** të raportuara nga institucionet publike me qëllim fshirjen e shpejtë të materialit të dëmshëm. Së fundi, nën mbështetjen e projektit **“Ekosistem kibernetik më i sigurt nga ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri”**, ky sistem kombëtar raportimi është bërë i mundur që të mbledhë sinjalizime edhe nga publiku i gjerë.

Heqja e shpejtë e materialit të paligjshëm është shpesh thelbësore në mënyrë që të kufizohet përhapja më e gjerë e propagandës ekstremiste apo materialeve që çënojnë dinjitetin e fëmijëve online. Për këtë arsye platformat që ofrojnë shërbimet në internet duhet të jenë në gjendje të marrin veprime të shpejta për të fshirë përmbajtje lehtësisht të identifikueshme sit ë paligjshme në internet edhe pa pritur që ky veprim të kërkohet në bazë të një urdhri gjykate ose një vendimi administrativ.

Mesazhe që nxisin akte terroriste apo imazhe të dhunës apo abuzimit seksual të fëmijëve, duhet të bllokohen pa humbur kohë nga ofruesit privatë të shërbimeve online për të penguar përhapjen e mëtejshme të tyre. Për të rritur efektivitetin e këtyre veprimeve nevojitet një bashkëpunim i ngushtë i autoriteteve publike dhe platformave private, por edhe përdoruesve të internetit për të identifikuar dhe sinjalizuar në kohë përmbajtjen e dëmshme. Portali unik i raportimit mundëson një mekanizëm për të mbledhur informacion dhe ulur së bashku të gjitha këta aktorë për të ofruar zgjidhje efektive.


⁹ VKM nr. 141, datë 22.2.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, neni 14 pika 21

FUNKSIONIMI I PORTALIT TË RAPORTIMIT

Në portalin online mund të ndërveprojnë njëkohësisht:

- Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), si administrator i portalit;
- Institucionet e autorizuara si Policia e Shtetit, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP), Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit (AMLF), Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF), Agjencia Shtetërore e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve (ASHMDF), si përdorues të portalit;
- Ofruesit e shërbimit të aksesit në internet (ISP-të), si përdorues të portalit.

Gjithashtu, portali është i hapur për publikun e gjerë (përdoruesit), të cilët mund të realizojnë raportime nëpërmjet modulit/ butonit të aksesueshëm aktualisht në faqen zyrtare të AKCESK www.cesk.gov.al



Institucionet e autorizuara kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

- Dorëzojnë elektronikisht në Portalin Online faqet / listën e faqeve me përmbajtje të paligjishme sipas konstatimeve të tyre.
- Publikojnë në Portalin Online vendimin për mbylljen e aksesit të faqeve me përmbajtje të paligjishme;

- Njoftohen me një sinjal (alert) për faqet për të cilat nuk është bërë akoma mbyllja e aksesit;
- Përditësojnë listën e publikuar të faqeve me përmbajtje të paligjshme;

Ofruesit e shërbimit të aksesit në internet (ISP-të) kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

- Të aksesojnë portalin të paktën një herë në 24 orë dhe të realizojnë mbylljen e aksesit të faqes/faqeve me përmbajtje të paligjshme brenda 3 ditëve kalendarike.
- Në raste emergjente duhet të realizojnë mbylljen e aksesit të faqes/faqeve me përmbajtje të paligjshme, menjëherë nga marrja e njoftimit.
- Kanë të drejtën e ankimit pranë institucioneve të autorizuar ose para gjykatës kompetente në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse;

RAPORTIMI NGA PËRDORUESIT E INTERNETIT

Butoni i sinjalizimit pranë faqes së internetit www.cesk.gov.al krijon mundësinë për çdo përdorues nga publiku që të raportojë pranë Portalit përmbajtje të paligjshme online. Këto raportime regjistrohen në mënyrë automatike nëpërmjet sistemit dhe pas një filtrimi nga autoritetet ligjzbatuese raportohen pranë ofruesve të shërbimit të internetit (ISP) me qëllim bllokimin e aksesit të faqes së internetit ku është shpërndarë materiali si dhe sinjalizohet më tej kompanitë ndërkombëtare që mundësojnë rrjetet sociale (Facebook, Twitter, Instagram etj).

Çfarë mund të raportohet nga qytetarët

■ Ekspozim ndaj imazheve të dëmshme

Interneti u ofron fëmijëve mundësi të shumta për t'u lidhur dhe për të mësuar, por gjithashtu mund t'i ekspozojë ata ndaj përmbajtjeve që janë të papërshtatshme për moshën dhe për zhvillimin e tyre. Nëse përdor internetin pa filtrimet e duhura



dhe pa mbikqyrjen e të rriturve, një fëmijë mund të hasë në mënyrë të paqëllimshme në përmbajtje të qartë seksuale, jashtëzakonisht të dhunshme ose të papërshtatshme. Ekspozimi ndaj kësaj lloji përmbajtjeje mund të jetë gjithashtu i dëmshëm psikologjikisht.

■ Cyberbullying

Bullizmi kibernetik ndodh kur një fëmijë apo adoleshent kërcënohet, keqtrajtohet, poshtërohet, tallet, ofendohet, apo vihet në shënjestër në mënyrë të qëllimshme nga një fëmijë ose adoleshent tjetër duke shfrytëzuar përdorimin e internetit, teknologjinë digjitale ose telefonat celularë.



■ Përmbajtje ekstremizmi të dhunshëm dhe radikalizmi

Përmbajtje e qartë terroriste online përkufizohen ato materiale që:

- kërkojnë ndjekës për të kryer ose për të kontribuar në vepra terroriste, ose për të marrë pjesë në aktivitetet e një grupi terrorist;
- nxisin ose mbrojnë veprat terroriste të kryera;
- ofrojnë udhëzime se si të kryhen sulme apo ndërtohen pajisje që shkaktojnë viktima.



Materiali i tillë përfshin tekst, imazhe, regjistrime zanore dhe video, si dhe transmetimet e veprave terroriste që nxisin rrezikun për përsëritjen e tyre nga ndjekësit.

■ Pornografi me të mitur në internet

Pornografia online e të miturve, shpesh e lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve, është një krim që ka gjetur hapësirë online duke shfrytëzuar rrjetet ilegale të internetit. Shumica e imazheve të abuzimit në internet janë të dhunshme dhe poshtëruese, dhe fëmijët që përdoren në prodhimin e imazheve të abuzimit seksual ka të ngjarë të përjetojnë shqetësime psikologjike dhe trauma emocionale.



■ Lojëra fati online

Lojërat e fatit në internet janë të ndaluara dhe ndëshkohen rreptësisht. Ligji nr.155/2015 "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", përcakton kuadrin e nevojshëm ligjor për mënyrën e organizimit, kushtet e funksionimit të lojërave të fatit dhe lejimin e shoqërive për të ushtruar këtë aktivitet.



SI MUND TË RAPORTOHET PËRMBAJTJA E PALIGJSHME / DËMSHME

Nëse jeni një shtetas shqiptar dhe hasni në internet materiale me përmbajtje të paligjshme të përshkruara në kategoritë e mësipërme, mund të raportoni pranë portalit të sinjalizimit nëpërmjet faqes zyrtare të AKCESK: www.cesk.gov.al

Raportimet për faqe të regjistruara jashtë Republikës së Shqipërisë me subjekt shtetas të huaj, rekomandohet të raportohen në mekanizmat respektivë të vendeve përkatëse për shkak të mungesës së juridiksionit të institucioneve përgjegjëse shqiptare si dhe krijimit të një fluksi të panevojshëm raportimesh.

Mund të raportoni duke ndjekur hapat më poshtë:

■ Mblidhni prova

Siguroni vendndodhjen e përmbajtjes, për shembull, një adresë / URL të internetit dhe prova të tjera të imazheve apo materialeve që mund të ndihmojnë autoritetet për të dokumentuar më tej shkeljen. Pasi të keni mbledhur prova dhe informacione përkatëse, mund të filloni raportin tuaj.



■ Nisni raportimin sipas kategorive

Raportet mund të bëhen në mënyrë anonime nga ana juaj. Sidoqoftë, në rast se dëshironi që të njoftoheni më tej për ecurinë e sinjalizimit tuaj, do të jetë e nevojshme të vendosni të dhënat tuaja të kontaktit në formën e raportimit. Të dhënat tuaja do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi



për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe do të përdoren vetëm për qëllimet e funksionimit të mekanizmit të sinjalizimit.

■ Këshillohuni

Gjithashtu, nëse kërkoni këshillim të mëtejshëm për rastin e konstatuar, mund të kontaktoni Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në numrin **044-500-329** si dhe linjën telefonike kombëtare për ekstremizmin e dhunshëm në numrin **0800-4545**. Këto linja këshillimi janë falas dhe ruajnë konfidencialitetin e telefonuesve.



Nëse jeni të shqetësuar për një aktivitet kriminal dhe kërkohet ndihma e menjëhershme duhet të kontaktoni shërbimin e Policisë së Shtetit në numrin telefonik 11

Përdorimi i shërbimeve të dedikuara të raportimit në platformat e mediave sociale

Platformat e mediave sociale, të tilla si Facebook, Twitter, Instagram ose Tik-Tok, kanë një qendër sigurie për të ofruar udhëzime për përdoruesit dhe një shërbim raportimi për të sinjalizuar përmbajtje të papërshtatshme. Kjo zakonisht mund të gjendet në menunë "Ndihma". Raportimi i rasteve të ngacmimit, për shembull, në faqet e rrjeteve sociale mund të çojë në heqjen e shpejtë të përmbajtjes fyese dhe madje edhe fshirjen e llogarive të njerëzve që kanë thyer kushtet e përdorimit. Kjo mbetet edhe rruga më e shpejtë për të fshirë këtë përmbajtje.

Korrik 2021

Akademia e Studimeve Politike

Rr. "Emin Duraku", Pallati Credins,
kati i 7-të, zyra 21, Tiranë

Tel: +355 45 62 90 47 / Web: www.asp.al